



Në bazë të nenit 45 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-53683/19 07.03.2019, të pronareve Nebih, Januz dhe Nazmi Sinani nga Prishtina, dhe investitorit “Art Construction” L.L.C., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Faton Sinani nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, për seksionin “A”, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C9”, të Planit Rregullues “Mati I”, në rr. “Nezir Mujaj” hyrjet nr. 11/2012, 12/2012, 13/2012 dhe 14/2012, në Prishtinë dhe të pronares Naxhije Dermaku nga Prishtina, dhe investitorit “Art Construction” L.L.C., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Faton Sinani nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, për seksionin “C”, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C9”, të Planit Rregullues “Mati I”, në rr. “Xhafer Shala” hyrjet nr. 11/2012, 12/2012, 13/2012 dhe 14/2012, në Prishtinë Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 20.03.2019, lëshon këtë:

### CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** Nebih, Januz dhe Nazmi Sinani nga Prishtina, dhe investitorit “Art Construction” L.L.C., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Faton Sinani nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-53683/19 07.03.2019, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, lamela “A” me etazhitet B+P+9, e ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-230449 dt. 23.12.2013, në parcelën kadastrale nr. 1627-0 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 816-1, 816-3 dhe 944-4), e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-01627-0 ZK Matiçan, konkretisht në kuadër në bllokun urbane “C9”, të Planit Rregullues “Mati I” në Prishtinë dhe pronares Naxhije Dermaku nga Prishtina, dhe investitorit “Art Construction” L.L.C., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Faton Sinani nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-53683/19 07.03.2019, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, lamela “C” me etazhitet B+P+9, e ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-186309 dt. 05.12.2013, në parcelën kadastrale nr. 1627-0 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 816-1, 816-3 dhe 944-4), e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-01627-0 ZK Matiçan, konkretisht në kuadër në bllokun urbane “C9”, të Planit Rregullues “Mati I” në Prishtinë.

**II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, të ndërtuara në rrugët “Nezir Mujaj” hyrjet nr. 11/2012, 12/2012, 13/2012, 14/2012 dhe “Xhafer Shala” hyrjet nr. 11/2012, 12/2012, 13/2012, 14/2012, në Prishtinë, do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Pronareve Nebih, Januz dhe Nazmi Sinani nga Prishtina, me investitor “Art Construction” L.L.C., nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-53683/19 07.03.2019, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për



lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, lamela "A" me etazhitet B+P+9, e ndërtuar në kuadër të bllokut urbane "C9", të Planit Rregullues "Mati I" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1627-0 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 816-1, 816-3 dhe 944-4) ZK Matiçan, ndërtuar sipas Aktëvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-230449 dt. 23.12.2013, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës dhe pronares Naxhije Dermaku nga Prishtina, me investitor "Art Construction" L.L.C., nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-53683/19.07.03.2019, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, lamela "C" me etazhitet B+P+9, e ndërtuar në kuadër të bllokut urbane "C9", të Planit Rregullues "Mati I" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1627-0 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 816-1, 816-3 dhe 944-4) ZK Matiçan, ndërtuar sipas Aktëvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-186309 dt. 05.12.2013, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 356-193694 dt. 12.02.2019 për lamelen "A" dhe 09 Nr. 356-89614 dt. 20.02.2019 për lamelen "C" ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportet e Inspektimit Final, 09 Nr. 356-193694 dt. 20.12.2018 për lamelen "A" dhe 09 Nr. 356-89614 dt. 20.12.2018 për lamelen "C" të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës si dhe Inspektimin Final të dt. 20.12.2018, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Ibsoektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi i.d.a. Sevdar Bektashi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi i.d.n. Sami Idrizaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetillësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi i.d.h. Muhedin Morina; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi i.d.e. Kushtrim Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi i.d.m. Korab Krasniqi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Valon Bislimi me nr. të licensës 78;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetillësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.



Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm për lamelat "A" dhe "C".

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-53683/19 DT. 20.03.2019**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu

*B. Vllasaliu*

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Lindita Beqiri

